

RAPORT PERIODIK Nr. 1

6 – 15 maj

20 maj 2011

I. PËRMBLEDHJE

- Parlamenti votoi që të shpërndahet më 15 prill 2011 dhe zgjedhjet e hershme parlamentare u caktuan për më 5 qershor. Do të zgjidhen gjithsej 123 deputetë, përfshirë edhe për herë të parë një deputetë nga secila prej tre qarqeve të krijuara jashtë vendit.
- Këto janë zgjedhjet e para të cilat duhet të zbatohen që prej atëherë kur Kodi zgjedhor u ndryshua në prill, 2011. Amandmanet përfshijnë disa rekomandime të cilat paraprakisht janë dhënë nga OSBE/ODIHR, megjithatë, një numër i disa çështjeve mbeten të patrajtuara.
- Në këto zgjedhje do të garojnë gjashtëmbëdhjetë parti politike dhe dy koalicione. Nga ana e Komisionit shtetëror zgjedhor u refuzua një listë e kandidatëve të një partie dhe nga grup i votuesve, gjithashtu.
- Periudha përpara fillimit të fushatës ka qenë e tensionuar dhe e shënuar nga një retorikë të ashpër, ku të dy koalicionet e akuzonin njëri-tjetrin për akte të frikësimit të votuesve.
- Fushata zgjedhore 20 ditëshe fillon më 16 maj. Disa parti veç më kanë filluar që aktivisht ta promovojnë veten përmes reklamave nëpër gazeta, billboard dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore. KSHZ deklaroi se ato do ta shqyrtojnë çështjen e fushatës së hershme vetëm atëherë kur ato do të marrin ankesa nga garuesit në zgjedhje. Në kohën e raportimit, nuk janë dorëzuar kurrëfar ankesash.
- Numri përfundimtar i votuesve të regjistruar është 1,821,122, përfshirë edhe 7,258 të regjistruar të cilët do të votojnë jashtë shtetit. Listat votuese u bënë publike për shqyrtim publik mes 25 prillit dhe 4 majit, 18,662 votues i kanë kontrolluar të dhënat e tyre në zyrat lokale, përmes një programi kompjuterik dhe përmes emailave të dërguara tek zyrat e përcaktuara të KSHZ.
- Zgjedhjet administrohen nga një administratë tre-nivelëshe, përfshirë KSHZ, 84 Komisionet komunale zgjedhore dhe 2976 komisionet zgjedhore (KZ). Për herë të parë, 36 KZ shtesë do të vendosen në zyrat diplomatike dhe konsulare për ta lehtësuar votimin jashtë shtetit.
- Seancat e KSHZ janë të hapura për vëzhguesit, mediat dhe për publikun. Ato të cilat kanë qenë të mbikqyrura nga OSBE/ODIHR Misioni vëzhgues i zgjedhjeve kanë qenë shumë të politizuara. Diskutimet dhe votimet kanë qenë rreptësisht sipas linjave partiake, në veçanti atëherë kur mediat kanë qenë prezente. Në mungesë të mediave, diskutimet e KSHZ ishin më të relaksuara dhe më konsenzuale.
- Në vend ka një numër të madh të mediave, ndërsa televizioni është burimi kryesor për informatat politike. Këshilli transmetues ka miratuar një rregullore me çfarë rregullohet periudha mediale gjatë fushatës dhe për herë të parë edhe një për periudhën përpara fushatës.

- MVZ i OSBE/ODIHR i filloi aktivitetet e tij në Shkup më 6 maj, me një skuadër prej 12 anëtarëve të skuadrës qendrore. Më 9 maj, 20 vëzhgues afat-gjatë u pozicionuan nëpër shtet.

II. HYRJE

Parlamenti votoi shpërbërjen e tij më 15 prill 2011 dhe zgjedhjet e hershme parlamentare u caktuan për më 5 qershor. Në pritje të ftesës zyrtare nga Ministria për punë të jashtme, OSBE Zyra për institucione demokratike dhe të drejta njerzore (OSBE/ODIHR) dërgoi Mision për vlerësimin e nevojave (MVN) në Shkup prej më 5 deri më 7 prill.¹

Në bazë të rekomandimeve të MVN të OSBE/ODIHR, më 6 maj u krijua Misioni vëzhgues i zgjedhjeve (MVZ).² OSBE/ODIHR MVZ, i kryesuar nga Z. Julian Peel Yates, përbëhet nga 12 anëtarë të skuadrës qendrore dhe 20 vëzhgues afat-gjatë të pozicionuar në 10 lokacione nëpër shtet. OSBE/ODIHR ka kërkuar nga shtetet pjesëmarrëse që të dërgojë 300 vëzhgues afat-shkurtër për ti ndjekur procedurat e ditës zgjedhore. OSBE/ODIHR paraprakisht ka vëzhguar 11 zgjedhje në vend.³

III. KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e 5 qershorit do të jenë zgjedhjet e dyta të parakohshme parlamentare. Ato u organizuan pas një bojkoti më të gjatë të parlamentit nga Lidhja e social-demokratëve në Maqedoni (SDSM) dhe disa parti të tjera opozitare. Bojkoti filloi më 28 janar si përgjigje e acarimit të llogarive bankare të katër mediave si pjesë e hetimit kriminel lidhur me pronarin e *Televizionit A1*.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të organizuara më 1 qershor 2008, 63 mandate u fituan nga koalicioni i udhëhequr nga Organizata e revolucionit të brenshëm maqedonas – partia demokratike e bashkimit kombëtar maqedonas (VMRO-DPMNE), 27 nga koalicioni *Dielli* i kryesuar nga SDSM, 18 nga Bashkimi demokratik për integrim (BDI), 11 nga Partia demokratike shqiptare (PDSH) dhe 1 nga Partia për ardhmëri evropiane (PEI). Si pasojë u formua një koalicion qeveritar nga koalicioni i VMRO-DPMNE me BDI dhe PEI.

IV. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Kodi zgjedhor është ligji primar i cili i rregullon zgjedhjet parlamentare. U ndryshua në prill të vitit 2011 me një shumicë të vogël, ku partitë opozitare e bojkotuan votimin.⁴ Meqenëse shumica e afateve zgjedhore janë shkurtuar për pesë ditë për zgjedhjet e hershme, janë ngritur çështje për atë se nëse përgatitjet dhe informatat e nevojshme të cilat i përfshijnë palët e ndryshme elektorale mund të zbatohen brenda këtij afati.

Kodi zgjedhor i revizionuar adreson disa rekomandime të cilat paraprakisht janë dhënë nga OSBE/ODIHR. Megjithatë, një numër i çështjeve mbesin të paadresuara, përfshirë: një kornizë të shkurtër kohore për gjyqet dhe organet e administratës zgjedhore që të mund ti hetojnë dhe të vendosin për ankesat; ndalim i dërgimit të ankesave përmes postës; mungesë e qartësisë për të

¹ Raporti i MVN të OSBE/ODIHR është i disponueshëm në: www.osce.org/odihr/77051.

² Ueb faqja e MVZ është www.osce.org/odihr/elections/77359.

³ Të gjitha raportet janë të disponueshme në ueb faqen e OSBE/ODIHR: www.osce.org/odihr/elections/fyrom.

⁴ Amandmanet e zgjeruara të Kodit zgjedhor u miratuan më 5 prill 2011 (68 nga 120 deputetë). Në plotësim, ndryshimet e kufinjëve të njësive zgjedhore u miratuan më 13 prill.

drejtat kandiduese për ato të cilët kanë shërbyer dënimin për ndonjë krim të zbatuar; dhe të rishqyrtohet shuma maksimale e donacioneve për financimin e fushatës nga ana e korporatave.⁵

Do të zgjidhen gjithsej 123 anëtarë të parlamentit për një mandat katër vjeçar. 120 deputetë do të zgjidhen sipas sistemit të përfaqësimit proporcional nga gjashtë njësi zgjedhore, dhe për herë të parë një deputet do të zgjidhet sipas sistemit të mazhorancës nga secili prej tre qarqeve jashtë shtetit edhe atë nga Evropa dhe Azia, Amerika jugore dhe veriore, Australia dhe Azia.

Transparenca e financimit të fushatës është përforcuar nga kërkesa që partitë të dorëzojnë raporte periodike për shpenzimet e tyre lidhur me fushatën tek Komisioni shtetëror i zgjedhjeve (KSHZ), Shtëpia revizionuese shtetërore dhe Komisioni shtetëror për parandalim të korupsionit. Pastaj kërkohet që këto raporte të publikohen në ueb faqet e këtyre institucioneve. Megjithatë, nuk janë paraparë kurrëfar afatesh për verifikimin e raporteve të dorëzuara përpara ditës zgjedhore.

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Kodi zgjedhor parasheh një administratë zgjedhore tre-nivelëshe e cila e përfshin KSHZ, 84 Komisione komunale zgjedhore (KKZ), 2,976 komisione zgjedhore në vend (KZ) dhe deri më 50 komisione zgjedhore të vendosura jashtë shtetit në zyra diplomatike dhe konsulare.⁶

KSHZ është një organ i përhershëm, i emruar për një mandat katër vjeçar nga ana e parlamentit. Përbëhet prej shtatë anëtarëve dhe i menaxhon përgatitjet e përgjithshme për zgjedhjet. Kryetari i KSHZ dhe dy anëtarë janë të emruar nga partitë e opozitës parlamentare përderisa Zëvendës Kryetari dhe tre anëtarë janë të emruar nga partitë në pushtet. KSHZ aktual u emrua në 2008, megjithatë, kryetari dha dorëheqje më 23 shkurt 2011 dhe parlamenti zgjodhi pausës më 12 prill.

Seancat e KSHZ janë të hapura për mbikqyrësit ndërkombëtar dhe ato kombëtar nga shoqëria civile, si dhe për mediat. Seancat e dritashme të KSHZ të vëzhguara deri tani kanë qenë shumë të politizuara.⁷ Diskutimet dhe votimet ishën rreptësisht sipas linjave partiake, në veçanti kur mediat ishën prezente. Në mungesë të mediave, diskutimet e KSHZ ishën më të relaksuara dhe më konsenzuale.

KKZ janë përgjegjëse për menaxhimin e procesit zgjedhor në çdo komunë. KKZ janë trupa profesionale të përbërë nga pesë anëtarë dhe zgjidhen rastësisht nga nëpunësit shtetëror dhe të punësuarit në administratën publike. Të gjithë anëtarët e KSHZ ishën të emruar më 26 prill për një mandat prej pesë viteve.

KZ janë përgjegjëse për një vendvotim një ditë para dhe gjatë ditës së votimit. KZ përbëhen duke përdorur modelin e përzier profesionalo-politik, me një anëtarë të emruar nga partitë politike në pushtet, një nga partitë opozitare dhe tre anëtarë të zgjedhur rastësisht nga të punësuarit në administratën publike. Të gjitha organet zgjedhore të nivelit më të ulët ndjekin parimin e “përfaqësimit adekuat dhe të drejtë” të grupeve etnike dhe gjinisë. Megjithatë, KSHZ ka vetëm një anëtarë të gjinisë femrore.

KSHZ ka krijuar një program të detyrueshëm trajnues për komisionet zgjedhore të niveleve më të ulta i cili filloi më 4 maj dhe i përfshiu KZ për vendvotimet jashtë shtetit.

⁵ Kodi zgjedhor, neni 83(2). Personat juridik mund të japin donacion në një shumë deri më pesë përqind nga të ardhurat e tyre totale në vitin e kaluar.

⁶ Për këto zgjedhje do të ketë 36 KZ jashtë shtetit. Tjerat 14 KZ nuk e arritën kërkesën për minimum 10 votues të regjistruar me qëllim që të hapen.

⁷ MVZ i OSBE/ODIHR që nga pozicionimi i tij i ka vëzhguar të dy seancat e mbajtura të KSHZ.

VI. LISTAT E VOTUESVE

Përgjegjësia për freskimin dhe mirëmbajtjen e listave të votuesve mbetet tek KSHZ. Pastrimi i listave zgjedhore u organizua mes 25 prill dhe 4 maj. Ekstraktet ishën të disponueshme për inspektim në zyrat regjionale dhe lokale të KSHZ përmes një programi kompjuterik dhe përmes dërgimit të emaileve deri tek zyrat e KSHZ. Sipas informatave të publikuara në ueb faqen e KSHZ 18,662 njerëz i kanë kontrolluar të dhënat e tyre gjatë kësaj periudhe nga të cilët 42 persona janë regjistruar si votues të rinj, 756 të vdekur janë shlyer *ex officio*,⁸ 6 të vdekur janë shlyer në kërkesë të qytetarëve, 210 ndryshime të të dhënave personale janë kërkuar nga qytetarët dhe 24 persona kanë aplikuar për tu regjistruar mirëpo kanë qenë të rrefuzuar.

KSHZ më 15 maj shpalli se lista finale e votuesve për zgjedhjet parlamentare të vitit 2011 do të përmbajë 1,821,122 votues, 29,000 më tepër se zgjedhjet presidenciale dhe lokale të 2009. Gjithsej 7,258 njerëz janë regjistruar për të votuar jashtë shtetit.⁹ 4,653 në njësinë zgjedhore shtatë e cila e përfshin Evropën dhe Afrikën, 1,832 në njësinë zgjedhore tetë e cila e përfshin Amerikën veriore dhe jugore dhe 773 në njësinë zgjedhore nëntë e cila e përfshin Australinë dhe Azinë.

VII. GARUESIT DHE ATMOSFERA E FUSHATËS

Në zgjedhjet parlamentare mund të garojnë kandidatë të emruar nga parti politike, koalicione të partive politike ose nga kandidatë të pavarur të emruar nga grupe të votuesve. Dy koalicione të mëdhaja, njëra e udhëhequr nga SDSM dhe tjetra nga VMRO-DPMNE,¹⁰ si dhe gjashtëmbëdhjetë parti dorëzuan lista të kandidatëve tek KSHZ në afatin e 5 majit dhe do të garojnë në këto zgjedhje. Listat e kandidatëve nga njëra parti si dhe nga një grup i qytetarëve janë rrefuzuar nga ana e KSHZ.¹¹

Edhe pse periudha zyrtare e fushatës nuk fillon deri më 16 maj, klima politike ka qenë disi ndarëse si dhe është përdorur një retorikë e ashpër, në veçanti nga koalicionet e kryesura nga VMRO-DPMNE dhe SDSM, të cilat ndërmjetësisht janë akuzuar për sjelljen joligjore në përpjekje për të ndikuar mbi zgjidhjen e lirë të votuesve. Ka pohime të shpërndara gjerësisht për kërcnime për humbje të punës ndaj nëpunësve shtetëror nëse ato nuk sigurojnë ndonjë numër të caktuar të votuesve për koalicionin qeverisës. MVZ i OSBE/ODIHR ka marrë disa dokumente nga disa burime lidhur me këto pohime. Të dyja partitë kanë bërë publike dokumente të cilat kanë disa lista të cilat përmbajnë emra të njerëzve të cilët supozohet se janë presionuar që të votojnë për oponentin. VMRO-DPMNE ka deklaruar se do të iniciojë padi kundër *Televizionit A1* për transmetimin e një lajmi për frikësime të supozuara, si dhe kundër SDSM për ryshfet të votuesve.

⁸ Regjistri i qytetarëve mirëmbahet nga Ministria për punë të brendshme e cila kishte detyrë që ti fshijë të vdekurit nga Regjistri i qytetarëve deri më 16 mars 2011.

⁹ Sipas KSHZ ka rreth 80,000 qytetarë të cilët janë regjistruar se përkohësisht jetojnë ose punojnë jashtë shtetit. Fragmente speciale nga listat votuese me të dhëna u dërguan në zyrat diplomatike dhe konsulare përmes Ministrisë për punë të jashtme për qëllime të kontrollës publike njëjt si edhe kontrollat publike që ndodh në vend.

¹⁰ Koalicioni i SDSM përfshin 15 parti dhe koalicioni i VMRO-DPMNE përfshin 23 parti. Të dy koalicionet përfshijnë përfaqësim politik nga bashkësitë më të vogla etnike.

¹¹ Partia për aksion demokratik (PAD) u rrefuzua për shkak se dështoi që të dorëzonte listë komplete të kandidatëve në të gjitha njësitë zgjedhore. Lista e dorëzuar nga grupi i votuesve, “Zorancho Zlatevski”, u rrefuzua për shkak të pamundësisë që ta grumbullojë numrin e nevojshëm të nënshkrimeve.

Atmosfera duket se është më e qetë në arenën politike shqiptare. Dy rivalët tradicional, BDI dhe PDSH kanë nënshkruar pakt elektoral duke e zotuar veten për një proces demokratik të zgjedhjeve, ta përmbajnë veten nga fjalori i urrejtjes, ofendimeve dhe provokimeve dhe ti pranojnë rezultatet zgjedhore. Dy partitë e reja shqiptare, Demokracia e re (DR) dhe Rilindja demokratike kombëtare (RDK) po garojnë për herë të parë.

Më 12 maj të gjitha partitë politike nënshkruan Rregullore të sjelljes. Nënshkruerit e zotuan veten që të promovojnë zgjedhje demokratike, një klimë të tolerancës dhe haptas ta dënojnë dhunën dhe frikësimin.

Disa parti kanë filluar që aktivisht ta promovojnë veten përpara fillimit zyrtar të fushatës. Dukuritë e fushatës së hershme përfshijnë reklama të paguara prej dy faqeve në disa gazeta, linqe të dhëna në gazeta për disa video të postuara në internet dhe shpërndarjen e materialit promovues. Në Shkup janë paraqitur billborde në të cilat shkruan “A jeni për fitore” me një po të rrethuar¹² si dhe të tjera të cilat përkrahin disa parti politike të caktuara.

KSHZ tha se do ta shqyrtojë çështjen e fushatave të hershme vetëm nëse marrin ankesa nga garuesit në zgjedhje. Në moment, KSHZ nuk ka marrë kurrëfar ankese lidhur me këtë çështje.

VIII. MEDIA

Në shtet ka një numër të madh të media përfshirë 14 televizione kombëtare, 12 satelitore dhe 130 televizione regjionale, si dhe 10 gazeta ditore. Televizionet mbesin burimi kryesor për informim politik, ndërsa transmetuesit kombëtar mbizotërojnë në tregun e reklamimit.

Ndjekja e fushatës zgjedhore rregullohet nga Kodi zgjedhor dhe Ligji për aktivitet transmetues. Në plotësim Këshilli transmetues (KT) miratoi një rregullore e cila e rregullon ndjekjen e peridhës së fushatës dhe për herë të parë një rregullore për rregullimin e periudhës përpara fushatës.

KT e ndjek përmbushjen e legjislacionit dhe rregulloreve nga ana e mediave transmetuese. Që nga 15 prill ky organ ka mbykqyrë 16 media - transmetues kombëtar. Më fillimin zyrtar të fushatës më 16 maj, KT ka për qëllim që të mbikqyrë 154 media transmetuese. Gjatë periudhës raportuese KT paditi *Kanal 5* and *A1 Television* për mosdhënien e informatave të mjaftueshme gjatë botimit të rezultateve nga hulumtimet publike dhe *TV Alb* për transmetimin e reklamave politike përpara fillimit të fushatës. Në plotësim, vërejtje ju dërguan katër mediave (*MTV 1*, *Kanal 5*, *A1 Television*, and *Radio Metropolis*) ku theksohet se transmetimi i reklamave të paguara nga shteti është i ndaluar pas shpalljes së zgjedhjeve.

Neni 76(a) i Kodit zgjedhor kërkon që transmetuesi publik, Radio televizioni maqedonas (RTVM), të ofrojë kohë falas për reklamim për të gjithë kandidatët. Më 10 maj, MRTV vendosi që ti lejojë çdo garues politik, tre minuta për secilën njësi zgjedhore ku partia/koalicioni po garon. Ligji nuk e përcakton se në cilët orë do t’ju ofrohet kohë falas për reklamim. MRTV vendosi që të lejojë kohë mes 16.00 dhe 16.30, qartë jasht orarit kryesor të shikueshmërisë. Në plotësim MRTV planifikon që të organizojë 14 debate 90 minutëshe mes garuesve zgjedhor.

MVZ i OSBE/ODIHR zbaton vëzhgim të mediave në dy periudha kohore: 9 maj deri më 15 maj, e cila kohë e përfshin periudhën përpara fillimit zyrtar të zgjedhjeve. E dyta do ta përfshijë fushatën zyrtare prej më 16 maj deri më 3 qershor. Mbikqyrja e mediave përbëhet prej analizave

¹² Asnjë parti politike nuk ka marrë përgjegjësi për billbordet në të cilat shkruan “A jeni për fitore”.

kuantitative dhe kualitative të dy transmetuesve publik dhe pesë TV kanaleve private, si dhe pesë gazeta ditore.¹³

IX. ANKESA DHE PARASHTESA

Kodi zgjedhor jep disa udhëzime juridike për mbrojtjen e të drejtave zgjedhore përfshirë edhe parashtesa për çështje lidhur me regjistrimin e votuesve, parashtesa kundër rrefuzimit të regjistrimit, ankesa për shkelje të fushatës dhe rezultateve zgjedhore. Të gjitha këto bien nën juridikcion të organeve të ndryshme për ankesa. KSHZ është organi kompetent për tu marrë me ankesat nga kandidatët dhe votuesit lidhur me procedurat zgjedhore. Vendimet e KSHZ mund të parashtrohen në Gjyqin administrativ. Ankesat për parregullësitë zgjedhore duhet ti dorëzohen Gjyqit themelor, vendimet e të cilit mund të parashtrohen në Gjyqin apelues. Ankesat kriminele gjithashtu mund të parashtrohen në Gjyqin themelor dhe mund të rishqyrtohen nga Gjyqi apelues. Parashtresat më tej mund të ndërmerren nga Gjyqi suprem si instanca e fundit. Prokurori publik ka mandat që të nisë hetim kriminel çdoherë kur të informohet për ndonjë shkelje zgjedhore.

Në kohën e raportimit, nuk janë inicuar ankesa formale lidhur me listat zgjedhore ose regjistrimin e kandidatëve. Më 11 maj, prokurori publik inicioi hetim lidhur me një rast të dyshuar për frikësim nga ana e VMRO-DPMNE, siqë është raportuar në media.¹⁴ Prokurori publik e informoi OSBE/ODIHR se rasti do të trajtohet si një procedurë urgjente dhe do të zgjidhet përpara ditës zgjedhore.

X. AKTIVITETE TË KVZ

KVZ i OSBE/ODIHR i filloi aktivitetet e tij në Shkup më 6 maj, me një skuadër prej 12 anëtarëve. Deri tani KVZ i OSBE/ODIHR është takuar me Kryeministrin, Ministrin e drejtësisë, Ministrin e punëve të brenshme, Ministrin e punëve të jashtme, liderët e të gjitha partive më të mëdha politike, media, grupe të mbikqyrësve vendor, Kryesuesin e përkohshëm të Misionit të OSBE-së në Shkup dhe ambasadorë të shteteve pjesëmarrëse në OSBE. Njoftimi i parë për bashkësinë diplomatike u mbajt më 16 maj.

Asambleja parlamentare e OSBE (AP OSBE) dhe Asambleja parlamentare e Këshillit të Evropës do të dërgojë delegacioni për mbikqyrje të ditës zgjedhore. Kryesuesi i Zyrës së OSBE-së e ka emruar Z. Roberto Battelli, nga AP OSBE dhe përfaqësues special për Evropën jug-lindore për ta udhëhequr mision mbikqyrës afatshkurtër të OSBE-së për këto zgjedhje.

¹³ Kanale televizive: *MTV-1* (publike), *MTV-2* (publike), *Televizioni A1*, *Kanal 5*, *Sitel*, *Alsat-M* dhe *Telma*. Gazeta: *Dnevnik*, *Nova Makedonija*, *Vreme*, *Koha*, *Lajm*.

¹⁴ *Televizioni A1* raportoi se VMRO-DPMNE i ka urdhëruar kryesuesit e sektoreve në institucionet shtetërore të dorëzojnë lista të më së paku 15 personave të cilët do ta japin përkrahjen e tyre për këtë party dhe si kthim do të fitojnë punësim ose beneficione të tjera.